



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 5757 Prot

Shkodër, më 09.04.2019

URDHËR

Nr. 275, datë 09.04.2019

PËR
ORGANIZIMIN E PUNËS GJATË SEZONIT TURISTIK

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, nenet 23-29, të ligjit nr. 139 dt. 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar, të VKM nr. 171 datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria Juridike sëbashku me Drejtorinë e Turizmit të rishikojnë kontratën tip të zënies së hapësirës publike plazh, dhe ta përshtasin sipas modelit të VKM-së nr. 171 datë 27.03.2019. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
2. Pas konfirmimit të kontratës tip dhe konfirmimit nga Kryetari i Bashkisë, kontrata tip i dërgohet elektronikisht Zyrës me Një Ndalesë për uploadim në sistem.
3. Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, të përgatisë hartat dhe respektimin e ndarjes 80% privat dhe 20% publik, për secilën parcelë, në respekt të VKM-së nr. 171 datë 27.03.2019. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
4. Drejtoria e Turizmit në bashkëpunim me Drejtorinë e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse të marrë masa për hapjen e zyrës së informacionit turistik më datë 28 prill 2019. Për këtë të punohet për përmirësimin e infrastrukturës pritëse dhe stafin që duhet të emerohet me kontratë me afat. Të përcaktohen detyrat dhe kontrata e punës. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
5. Drejtoria e Turizmit do të organizojë aktivitetin e hapjes së sezonit turistik më datën **1 maj 2019.**
6. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit të hartojë planin e aktiviteteve të panairëve të organizuara nga Bashkia Shkodër në partneritet me shoqatën e artizanëve, ose organizata të tjera partnere. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
7. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të hartojë planin e aktiviteteve kulturore dhe sportive gjatë gjithë sezonit turistik. Në këtë plan të listohen aktivitetet, koha e zhvillimit. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**

8. Drejtoria e të Ardhurave të hartojë planin e punës për angazhimin e inspektorëve në territor: 1) për taksapaguesiet biznes; 2) për taksapaguesit familjar. Periudha e angazhimit do të jetë 1 maj 2019 – 15 shtator. Për këtë të merret modeli i udherit, planit dhe metodologjisë së punës se ndjekur një vit më parë. Ky plan duhet të jëtë i vlefshëm për publikun, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe insitucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
9. Policia Bashkiake të hartojë planin e punës dhe urdhërin e punës për stafin e policisë bashkiake për periudhën maj 2019- 15 shtator 2019. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
10. Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, të përlllogarisë kostot e transportit (naftë, benzinë) dhe angazhimin e mjeteve sipas kalendarit të kërkuar kryesisht nga polica bashkiake, Drejtoria e të ardhurave dhe Drejtoria e shërbimeve Sociale.. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
11. Drejtoria e Shërbimeve publike të hartojë planin e punës për:
 - a. Pastrimin, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve për periudhën 1 maj 2019- 15 shtator 2019 në zonat turistike, Velipojë dhe Theth. Në plan të saktësohet numri i pikave, vendodhja, frekuenca, kush e monitoron dhe raportimi.
 - b. Ndricimin publik të zonës së plazhit, riparimin dhe vendosjen e sinjalistikës ujore në Plazh.**Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
12. Drejtoria e Shërbimeve Sociale të hartojë planin e punës për angazhimin e grupeve të terrenit në hyrje të qytetit, Muriqan dhe Velipojë. Njëkohësisht të planifikojë edhe angazhimin e mjetit dhe kalendarin. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
13. Drejtoria e Mjedisit, të hartojë planin e veprimit për monitorimin e zhurmave për periudhën e sezonit turistik, në zbatim të ligjit dhe VKM-ve përkatëse. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
14. Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të hartojë planin e punës për menaxhimin e territorit dhe garantimin e shërbimit zjarrfikës gjatë periudhës së sezonit turistik. **Afati është deri më datën 10 prill 2019.**
15. Administratori i njësisë Velipojë të përcaktojë listën emerore të punonjësve sezonal dhe të përgatisë dokumentacionin. Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse harton në bashkëpunim me administratorin përshkrimet e punës dhe kontratat e punës.
16. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen të gjitha drejtoritë.
17. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

